

2019 JUL 29 PM 3:04

**GJYKATËS THEMELORE-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVISIONI CIVIL,  
NË PRISHTINË**

NR.SHKR. BR.SPISA

**PALLATI I DREJTËSISË**

**PADITËSIT:**

- 1. ODA E INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS NGA PRISHTINA**
- 2. NASER RRUSTEMAJ NGA PRISHTINA, KRYETAR I ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS, NGA PRISHTINA TË PËRFAQSUAR NGA SZLEJMAN NUREDINI, PËRFAQËSUES ME PROKURË, NGA PRISHTINA**

**PADITURIT:**

- 1. GAZETA PERIODIKE SHNETA NGA PRISHTINA**
- 2. ARTIKULLSHKRUESI-GAZETARI, BUJAR VITIA**

**Baza juridike: Kompenzimi i dëmit material dhe jo material për shkak të cënimit të së drejtave të personalitetit**

Vlera e kontestit: E papërcaktuar

]Prishtinë, me dt. 29.07.2019

Nuk është kontestuese se, me vendimin e Odës së infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës Nr.65 i dt. 28.01.2019, paditësi Naser Rrustemaj është zgjedhur kryetar i kuvendit të Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës të Kosovës.

PROVË: Vendimi nr.65 i dt. 28.01.2019

Po kështu nuk është kontestuese se me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës me Nr.të protokolit 05-6898 i dt. 01.12.2014, paditësit të dytë Naser Rrustemaj në cilësinë e kryetarit të Odës së Infermierëve të Kosovës i është caktuar paga mujore prej 1,000.00 Euro.

PROVË: Vendimi Nr. 056898 i dt 01.12.2014

Sipas vendimit të Odës së Infermierëve të Kosovës Nr.8/2 i dt. 23.01.2018, Paga e kryetarit të Kuvendit të kësaj Ode caktohet për çdo muaj në shumë prej 1,000.00 Euro.

PROVË: Vendimi Nr.8/2 i dt. 23.01.2018

Nuk është kontestuese se,gazeta periodike "Shneta" i dt. 08.06.2019, ka nxjerrë dhe rrjedhimisht ka publikuar lajme të pavërteta duke i prezentuar në mënyrë të rrejshme lidhur me atë deklaratën se gjoja kryetari i Kuvendit të Odës së Infermierëve Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës të Kosovës, ia cakton pagën vetes në shumë prej 1,500.00 Euro. Ndonëse,artikullshkruesi duke qenë tërësisht dhe saktësisht i vetdijshtëm se Kryetari i Kuvendit të Odës së infermierëve Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës të Kosovës, nuk e ka pagën prej 1,500.00 Euro, por megjithatë publikon këtë lajm si të pavërtetë,të rrejshëm dhe rtrjedhimisht shpifës në gazetën periodike "Shneta" i dt. 08.06.2019.

Përhapja e këtyre lajmeve të pavërteta, të rreme me konstruksione shpifëse, denigruese me attribute fyese jo vetëm që, janë sajesa të formulimeve steriotipe me parafrazie të cinguarra dhe boshe por të njëjtat janë të pabazuara, të papranueshme dhe rrjedhimisht bie ndesh me dispozitat e nenit 5 par.1 dhe nenit 2 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Duke qenë se,të paditurit kanë ditur se publikimi i një deklarate të tillë se paditësi i dytë ia ka caktuar vetes pagën në shumë prej 1,500.00 Euro,është e rreme. mashtruese e pavërtetë, konfirmohet edhe nga vendimi i Këshillit të mediave të shkruara të Kosovës me dt. 11.06.2019/800-2019 i dt. 04.07.2019.

PROVË: Vendimi i Këshillit të mediave të shkruara të Kosovës me dt. 11.06.2019/800-2019 i dt. 04.07.2019.

Me këtë vendimi konstatohet se të paditurit arbitrarisht dhe në mënyrë të pabazuar kanë publikuar në gazetën periodike shneta se paditësi i dytë ja ka caktuar vetes pagën prej 1,500.00 Euro.

Ndonës, paditësit ka konfirmuar se pretendimet e të paditurit ishin të pavërteta, mashtruese,por megjiate të paditurit kanë përhapur deklarata të rreme me qëllim të cënimit të dinjitetit,reputacionit dhe autoritetit të paditësit të dytë-kryetarit të Kuvendit të Odës së Infermierëve të Kosovës.

Ndonëse, të paditurit sipas dispozitës së nenit 6 të Ligjit Civil kundër shpifjes dhe fyerjes kanë pasur detyrimin e barrës së të provuarit për publikimin në gazetën periodike Shneta me datë 08.06.2019 se kryetari i Odës së Infermierëve ja cakton vetes rrogën prej 1,500.00 euro, por për këto deklarata dhe publikime të pasakta, të pavërteta, të rrejshme, spekulative dhe arbitrare nuk kanë paraqitur asnjë provë juridikisht të vlefshme dhe duke mos propozuar asnjë fakt relevant. Ndonëse dinjiteti dhe integriteti personal i paditësit të dytë është i pacënueshëm, i garantuar me dispozita kushtetuese dhe ligjore, por me veprime të tilla spekulative, arbitrare, abuzive dhe rrjedhimisht të kundërligjshme paditësit i është cënuar dinjiteti, nderi, autoriteti dhe prestigji i tij me përhapjen dhe botimin e këtyre deklaratave të pavërteta, mashtruese dhe të rrejshme.

PROVË: Gazeta periodike shneta e dt. 08.06.2019

Qëllimi që dëshirohet të arrihet me publikimin e këtyre deklaratave mashtruese në gazetën periodike "Shneta" është që, padisin ta diskreditojnë, denigrojnë dhe diskualifikojnë dhe rrjedhimisht e vënë në pozitë substancialisht të pabarabartë, të pafavorshme dhe rrjedhimisht diskriminuese.

Përhapja e këtyre të pavërtetave, me deklarata mashtruese nëpërmjet mjeteve të informimit nuk mund të shpjegohet dhe sqarohet ndryshe përpos vënies në funksion të realizimit të interesave klienteliste dhe grupe duke i shkaktuar paditësit dëm sikundër material dhe jomaterial.

Sipas dispozitës së nenit 5 par.2 të Ligjit Civil kundër shpifjes dhe fyerjes bashkëpërgjegjës janë sikundër autori i publikimit-shkrimit ashtu edhe vetpublikuesi gazeta periodike "Shneta".

Duke qenë se, provat të cilat i ka paraqitur paditësi kanë fuqinë dhe vërtetësinë absolute atëherë sipas nenit 321 par.4 lidhur me nenin 329 par.1 të LPK-së atëherë, faktet e tilla Gjykata nuk duhet provuar por merren si të provuara.

Sipas dispozitës së nenit 13 të Ligjit Civil kundër shpifjes dhe fyerjes të paditurit nuk i kanë mundësuar paditësve të drejtën e reagimit në gazetën periodike "Shneta". Publikimi i artikullit të rremë në gazetën periodike "Shneta" se kryetari i Odës së infermierëve ia cakton vetes rrogën 1,500.00 Euro, ka pasur për qëllim cënimin e dinjitetit, integritetit dhe autoritetit të paditësve duke iu shkaktuar dëm material dhe jomaterial jo vetëm për të por edhe më gjërë. Përhapja e këtyre lajmeve të pavërteta, arbitrare kanë efekte përbuzëse me paraqitjen e shtrembëruar dhe mashtruese të tyre, por janë në funksion të krijimit të efekteve negative dezinformuese dhe diskredituese të paditësit të dytë.

Në bazë të gjendjes së tillë të çështjes sipas dispozitës së nenit 190 të LMD, paditësve iu është shkaktuar dëm materjal dhe jomaterial me përpjestimime të mëdha që është reflektuar sikundër në qarqet profesionale por edhe më gjërë, e aq më keq që të paditurit nuk ia kanë mundësuar dematin paditësve në gazetën periodike të të tyre.

Pikërisht për këto shkaqe dhe arsye i propozojmë Gjykatës kompetente që pas administrimit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të propozuara dhe fakteve të treguara me ndërgjegje dhe kujdes një nga një dhe të tëra së bashku, sipas dispozitës së nenit 8 të LPK-së të merr këtë:

## AKTGJYKIM

### I

1. Pranohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve -Dhomës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës të Kosovës. të Kosovës dhe kryetarit të Kuvendit të saj Naser Rustemajt
2. Detyrohen të paditurit gazeta periodike "Shneta" me seli në Prishtinë dhe artikullshkruesi i saj Bujar Vitia që në mënyrë solidare paditësve në emër të dëmit material t'a paguaj në shumë prej 10,000.00 Eur, si rrjedhojë e shpifjes dhe fyerjes se gjoja kryetari i Odës së Infermierëve ia cakton vetes rrogën 1,500.00 Euro.
3. Detyrohen të paditurit që paditësit t'ia kompenzojnë dëmin jomaterial për shkak të vuajtjeve dhe dhimbjeve shpirtërore si pasojë e shpifjes dhe fyerjeve të paditurve gjoja se paditësi Naser Rustemaj në cilësinë e kryetarit të Odës së Infermierëve ia cakton vetes rrogën 1,500.00 Euro, në shumë prej 10,000.00 Euro.
4. Detyrohen të paditurit që me publikimin në Gazetën periodike Shneta të revokojnë informacionin e shpifjes dhe fyerjes ndaj personalitetit të paditësit se kryetari i Odës së Infermierëve ia cakton vetes rrogën prej 1,500.00 Euro.
5. Detyrohen të paditurit që paditësit t'ia paguajnë dëmin material dhe jomaterial nga par.II dhe III të këtij dispozitivi të këtij aktgjykimi në shumë prej 20,000.00 Eur, me kamatë prej 8% në vit duke filluar prej 08.06.2019, deri në pagesën definitiv, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kanosjen e përmbarimit të detyrueshëm
6. Detyrohen të paditurit që t'ia kompenzojnë paditësve shpenzimet e procedurës kontestimore, aq sa do të bëhet sipas listës së shpenzimeve.

### II

Duke qenë se, tashmë paditësi ka bërë të besueshme dhe madje të sigurtë ekzistimin e kërkesës lidhur për cënimin e të drejtave të personalitetit si dhe rrjedhimisht lartësinë e kompenzimit të dëmit material dhe jomaterial si dhe pa caktimin e kësaj mase sipas nenit 297 par.I nënparagrafi a) dhe b) të LPK-së, të paditurit do të vazhdojnë me përhapjen e deklaratave dhe informacionit shpifës dhe fyes nëpërmes gazetës periodike "Shneta", duke i shkaktuar dëm të mëtejshëm, të pariparueshëm dhe të pakompenzueshëm material dhe jomaterial për shkak të cënimit të prestigjit

dhe dinjitetit të paditësve. Prandaj i propozojmë Gjykatës kompetente që sipas nenit 16 të Ligjit Civil kundër shpifjes dhe fyerjes dhe nenit 301 par.1 të LPK-së të merr këtë

#### URDHËRESË GJYQËSORE PARAPRAKE ME CAKTIMIN NË MASË TË SIGURISË

1. I ndalohet autorit-gazetarit... si dhe rrjedhimisht gazetës periodike “Shneta” që mëtej të përhapin me publikime informacione shpifëse dhe fyese kundër paditësve duke shkaktuar dëm material dhe jomaterial.
2. Ndalimi i publikimit të informatave të tilla nga par.1 i këtij urdhëri gjyqësor hyn në fuqi menjëherë dhe ka për tu publikuar në gazetën periodike “Shneta”
3. Nëse të paditurit nuk e zbatojnë urdhërin nga par.1 dhe 2 të kësaj mase të sigurisë atëherë i nënshtrohen sanksioneve civile-juridike dhe penale-juridike.

Paraqitësi i padisë,  
Sylejman Nuredini, përfaqësues me prokurë i paditësve,  
Lagja Ulpiana U2, Nr.10, Prishtinë